



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.682/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Suharek, paraqitur kundër Fidaije Kukaj Kryesuese e VV 2406A/02R, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë si e pasafatshme ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)

A R S Y E T I M

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 22.12.2010, nga subjekti politik AAK, në të cilën pretendohet se me datën 12.12.2010 në VV nr 2406A/02D gjatë bartjes së rezultateve nga “FLIK” në “FRK” është bërë një gabim me ose pa qëllim, ku votat e kandidatit të AAK-ës me nr 7 ju kanë bartur kandidatit me nr.6, të cilin gabim po e pranon edhe kryesuesja e këtij vendvotimi e cila vjen nga rradhët e PDK-ës. Komisionarja nga AAK-ja është votuese në të njëjtin vendvotim dhe deklaroi se nga vetë ajo janë lexuar votat për kandidat të subjektit politik të AAK-ës, ku kandidati nr.7 kishte 7(shtatë) vota, kurse kandidati me nr 6 kishte 1 (një) votë dhe kandidati me nr 5 nuk kishte asnjë votë. Gjatë bartjes së rezultateve nga “FILK” në “FRK” është bërë gabim me ose pa qëllim nga kryesuesja Fidaije Kukaj nga rradhët e PDK ku një votë e kandidatit me nr 6 është shënuar te kandidati nr 5 dhe shtatë vota të kandidatit nr 7 janë shënuar te kandidati nr 6 dhe kandidati nr 7 ka mbetur pa asnjë votë. Sipas parashtruesit të ankesës për këto raste kemi dëshminë e vëzhguesit dhe pohimin e të gjithë komisionerëve të pranishëm që kanë qenë aty dhe realiteti gjendet në “FLIK”-at që gjinden në kutin e VV 2406A/02D

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi: listën me emra të komisionarëve dhe vëzhguesve të këtij vendvotimi, listat e shënimeve nga vëzhguesit e AAK-ës, dhe fotokopjet e FRP-ës dhe FRK-ve nga VV 2406A/02D

Parashtruesi i ankesës propozon që të bëhet përmisimi i këtij gabim

Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së

Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes një ankesë pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga koha kur është parashtruar ankesa.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pasafatshme

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme, sepse rasti ka të bëjë me 12.12.2010 ndërsa ankesa në PZAP është pranuar me datën 22.12.2010 e afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 682/2010 më datën 23.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

